

VENDIM
Nr. 5, datë 21.1.2013

PËR VENDOSJEN E SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM DHE EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 4, DATË 21 JANAR 2013 “PËR HEQJEN E LICENCEVE PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE AKTIVITETIT TË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA”

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 18 pika 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 13 të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2005 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licenceve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008, të ndryshuar, dhe për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 25.1.2008, të ndryshuar”, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 1, datë 10.1.2013 “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 4 të rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.1.2013, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.1.2013,

VENDOSI:

1. Vënien në administrim të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., sipas nenit 18, pika 4 germa “ë” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Gjatë periudhës së përkohshme të administrimit pezullohen të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e organeve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., si dhe të aksionarëve të saj në funksion të detyrimeve të licencës.

3. Të gjitha funksionet dhe kompetencat e administrimit të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., i kalojnë administratorit të emëruar nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

4. Emërimi i z. Sahit Dollapi, si administrator i përkohshëm i shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., që të operojë dhe të mirëmbajë pajisjet, pasuritë dhe mjetet monetare, dhe llogaritë bankare të shoqërisë.

5. Administratori i emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në administrimin e përditshëm të shoqërisë, do të zbatojë rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe ka këto detyra të menjëhershme:

- Të marrë menjëherë në administrim shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a.;
- Të ndryshojë vulën e shoqërisë. Vula e re të reflektojë vënien në administrim të shoqërisë;
- Në të gjithë korrespondencën e shoqërisë së vënë në administrim të përkohshëm, të reflektojë ndryshimet e ndodhura në statusin e shoqërisë;
- Të ndryshojë rregullin e hyrjes në ndërtesat dhe në mjediset ku ruhen pasuritë, dokumentacioni, informacioni, pajisjet, përdorimi i të cilave dëmton interesat pasurorë të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., duke zëvendësuar kodet dhe fjalëkalimet, dhe duke vendosur kufizime të rrethit të personave që kanë të drejtë të hyjnë në këto mjedise;
- Të ndryshojë ose të krijojë fjalëkalime të reja për hyrjet në rrjetin kompjuterik, duke lejuar hyrjen në të, vetëm të punonjësve të autorizuar të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a.;
- Mund të ndryshojë kompetencat e personave, të cilët ushtrojnë veprimtari në emër dhe për llogari të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., duke autorizuar për ushtrimin e këtyre kompetencave

punëmarrës të tjerë, dhe për këto ndryshime njofton palët e treta dhe rregullatorin;

- Të ndjekë menjëherë procedurat për ndalimin e pagesës së dividendëve, transferimit të kapitalit aksionar të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., si dhe pagesën e administratorëve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., përveç shpërblimit për shërbimet që ata kanë bërë më parë.

6. Administratori i emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi, nuk mund të transferojë asnjë aset ose pasuri materiale të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., nëpërmjet shitjes, pengut, qirasë, shkëmbimit apo formave të tjera.

7. Statusi i shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., sipas këtij vendimi dhe administratori i emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi, bëhen publike nëpërmjet depozimit të këtij vendimi në QKR.

8. Depozitimi dhe publikimi i këtij vendimi në të dhënat e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. me numër NIPT: K72410014H, do të realizohet sipas autorizimit bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë menjëherë administratorin e emëruar sipas pikës 4 të këtij vendimi dhe shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani